

**VENDIM**  
**i Asamblesë së Përgjithshme**  
**të shoqërisë "HardTech" Sh.p.k**

Sot më datë 15.04.2024, në selinë e shoqërisë "HardTech" Sh.p.k, e regjistruar me NUIS M31310054F, me seli në Rr. "Ismail Qemali", Pallati 27, Kati 4, Hyrja 19, Tirana u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "HardTech" Sh.p.k, e përbërë nga Ortaku i vetëm i shoqërisë:

- **Z. Enea Buza** lindur me 23.01.1984 në Berat, identifikuar me **letërnjoftim me Nr. 036019622**, person madhor dhe me zotësi te plotë juridike e për të vepruar në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e tij të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, deklaron se Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë është mbledhur rregullisht bazuar në ligjin nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe e aftë për të marrë vendime sipas rendit të ditës në vijim:

Rend Dite:

**1. Miratimi i ndryshimeve në Statutin e Shoqërisë "HardTech" Sh.p.k;**

\*\*\*\*\*

1. Pika 1 e rendit të ditës miratimi i ndryshimeve në Statutim e Shoqërisë "HardTech" Sh.p.k,

Konkretisht:

- Ndryshohet pika 1 e nenit 12:

**Ishte:** "Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave."

**Behet:** "*Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 60+1 për qind të kuotave.*"

- Ndryshohet pika 2 e nenit 12:

**Ishte:** "Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji."

**Behet:** "*Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të*



*ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë 60 + 1 përqind të numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji."*

- Ndryshohet pika 1 e nenit 13:

**Ishte:** "1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë."

**Behet:** "**1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, për:**

- a. ndryshimin e statutit;
- b. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- c. shpërndarjen e fitimeve;
- d. emerimin ose shkarkimin e administratorit;
- e. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- f. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë."

- Ndryshohet pika 2 e nenint 13:

**Ishte:** "2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarres, për cështje të tjera si :

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve të personave të përcaktuar në pikat b dhe c të këtij paragrafi;
- dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- g. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

**Behet:** "**2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarres, për cështje të tjera si :**

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- c. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve të administratorit, likujdatorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar;

- dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;**
- e. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;**

- Ndryshohet pika 3 e nenit 15:

**Ishte:** "Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi."

**Behet:** "*Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të kualifikuar me ¾ e votave të zotëruarësëve të kapitalit. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.*"

Pas një shqyrtimi dhe vlerësimi të plotë, Asambleja e Përgjithshme në lidhje me rendin e ditës vendos me unanimitet:

VENDOSI:

- Të miratojë ndryshimet në Statutin e Shoqërisë "HardTech" Sh.p.k sipas pikës 1 të rendit të ditës.**
- Ngarkohet administratori i shoqërisë Z. Enea Buza, shtetas shqipëtar, lindur me 23.01.1984 në Berat, identifikuar me letërnjoftim me Nr. 036019622, për depozitimin e këtij Vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Përfaqësuesi i mësipërm për kryerjen e këtij veprimi ka tagrin e përgatitjes si dhe të nënshkrimit të çdo akti të nevojshëm për depozitimini e këtij Vendimi dhe të çdo dokumenti tjeter.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjeter për të diskutuar, Ortaku i Vetëm e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të mbyllur.

Ky vendim përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

**"HardTech" sh.p.k**

Ortaku i vetëm

Z. Enea BUZA

Enea Buza

